

PARTITË POLITIKE VS TRANSPARENCA NË FUSHATË

STANDET PËR TRANSPARENCËN E FUSHATËS SË SUBJEKTEVE
POLITIKE, RREGULLIMI LIGJOR DHE PRAKTIKAT MË TË MIRA

2018



PARTITË POLITIKE VS TRANSPARENCA NË FUSHATË

STANDARDET PËR TRANSPARENCËN E FUSHATËS SË SUBJEKTEVE
POLITIKE, RREGULLIMI LIGJOR DHE PRAKTIKAT MË TË MIRA

2018

COPYRIGHT © 2018.Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,
10000, Prishtinë, Kosovë.

Tel: +381 (0)38 248 038

E-mail: info@kdi-kosova.org

Web: www.kdi-kosova.org

Autori: **Florent Spahija**

Layout and design: **envinion**

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me mbështetjen e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës Çeke në kuadër të Programit për Promovimin e Tranzicionit përmes projektit SE.S.TRA. të implementuar në bashkëpunim me Transparency International CzechRepublic (www.transparency.cz). Opinionet, gjetjet dhe rekomandimet në këtë raport janë përgjegjësi ekskluzive e KDI-së dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorit.

PËRMBAJTJA

6

SHKURTESAT

7

HYRJE

8

RREGULLIMI LIGJOR NË LIDHJE
ME FUSHATËN ZGJEDHORE

10

KUFIZIMET FINANCIARE GJATË FUSHATËS
DHE DEKLARIMI FINANCIAR

12

PËRMBAJTJA E RAPORTEVE FINANCIARE

14

PRAKTIKAT DHE STANDARDET MË
TË MIRA NË FINANCIMIN DHE
SHPENZIMET E FUSHATËS ZGJEDHORE

17

TAKIMI ME SUBJEKTET POLITIKE DHE
REZULTATET E ANKETËS

20

AUDITORI PËR FUSHATË

21

PËRFUNDIM

22

SHTOJCA 1



SHKURTESAT

KDI	Instituti Demokratik i Kosovës
TI	Transparency International
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Zyra	Zyra për Regjistrim dhe Certifikim të Subjekteve Politike
BE	Bashkimi Evropian
LZP	Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme
LZL	Ligji për Zgjedhjet Lokale
TI CZ	Transparency International nga Republika Çeke
AAK	Aleanca për Ardhëmrinë e Kosovës
AKR	Aleanca Kosova e Re
LVV	Lëvizja Vetëvendosje!
NISMA SD	Nisma Socialdemokrate
PDK	Partia Demokratike e Kosovës



HYRJJE

Gjatë dy dekadave të para të pasluftës, Kosova ka organizuar shtatë palë zgjedhje lokale dhe gjashtë palë zgjedhje të përgjithshme. Kosova ka organizuar edhe zgjedhje të parakohshme parlamentare, të cilat ndodhën nga pamundësia e Kuvendit të Kosovës për ta përmbyllur mandatin e tij kushtetues 4- vjeçar.

Kosova, çështjen e zgjedhjeve, por edhe të fushatës zgjedhore e ka të rregulluar me Kushtetutë, Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale, e po ashtu edhe me legjislacionin dytësor që ndër vite është nxjerr nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për lehtësim dhe implementim më të mirë të ligjit. Kjo kornizë ligjore, përfshirë aktet nënligjore që lidhen me zgjedhjet, e rregullojnë aspektin e mbarëvajtjes së zgjedhjeve, ndërkohë që përditësimi i tyre si rezultat i mangësive të adresuara nga vëzhguesit vendorë e ndërkombëtarë të zgjedhjeve dhe nga vetë subjektet politike në vend ka ngecur. Kjo konfirmohet edhe nga Misioni Vëzhgues i Zgjedhjeve të Bashkimit Evropian, Raporti mbi zgjedhjet parlamentare 2017. Ky raport thekson se nga viti 2011, ka pasur disa përpjekje të pasuksesshme për reformim gjithëpërfshirës të sistemit zgjedhor dhe për të adresuar mangësitë e identifikuar më herët, duke përfshirë mundësinë e shpalljes së zgjedhjeve të parakohshme brenda një periudhe jashtëzakonisht të shkurtër, dhe si rezultat, afatet e shkurtuara kohore në kalendarin zgjedhor, që cungojnë disa të drejta zgjedhore.¹

Kjo analizë ligjore është përgatitur në kuadër të projektit të përbashkët të Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) dhe TransparencyInternational nga Republika Çeke (TI-CZ) për ngritjen e transparencës së subjekteve politike në Kosovë në fushatë zgjedhore, përkatësisht në shpenzimet dhe financimin e fushatave dhe financimin e subjekteve politike në përgjithësi. Duke iu referuar praktikave më të mira evropiane, si ajo e Republikës Çeke, KDI-ja synon të promovojë standardet për rritjen e transparencës në menaxhimin e fushatave zgjedhore, shpenzimet e fushatës zgjedhore, financimin e fushatës zgjedhore dhe financimin e subjekteve politike në përgjithësi që janë aplikuar dhe kanë rezultuar me sukses. Ndër to vlen të përmendet qasja "online" e publikut në llogaritë bankare të subjekteve politike për të parë se kush

e financon subjektin politik dhe sa para shpenzon ai subjekt në fushatë; bërja publike e planeve për mbajtjen e tubimeve dhe vizitave gjatë gjithë fushatës, obligimet për kandidatët të deklarojnë të gjitha shpenzimet e fushatës etj.

Ligjet në Kosovë nuk e rregullojnë një segment shumë të rëndësishëm, atë të financimit individual në fushatë, rrjedhimisht të kandidatëve për deputetë, por edhe të kandidatëve për kryetarë komunash. Në raportet financiare të subjekteve politike vazhdojnë të përfshihen vetëm shpenzimet e subjektit, por jo edhe të kandidatëve.

jatë dy cikleve të fundit zgjedhore, parlamentare dhe komunale 2017, KDI-ja ka zhvilluar anketë me subjektet politike në garë rreth çështjes së financimit të fushatave dhe shpenzimeve të fushatës, por edhe vullnetit të tyre për të treguar transparencë përballë publikut. Pyetësi është dërguar tek më shumë se 40 subjekte politike të regjistruara dhe të certifikuar për zgjedhje². Vetëm një numër i vogël i subjekteve politike i janë përgjigjur pozitivisht këtij pyetësi në zgjedhjet parlamentare. Megjithatë është vërejtur një gatishmëri më e madhe e disa subjekteve politike për të dhënë informacion gjatë zgjedhjeve komunale. Këto ndryshime në sjelljen e subjekteve politike të mëdha vlerësohen inkurajuese për vullnetin e tyre ndaj transparencës dhe llogaridhënies para publikut, synim ky edhe i KDI-së.

¹ Misioni Vëzhgues i Zgjedhjeve të Bashkimit Evropian, Raporti mbi zgjedhjet parlamentare 2017, f. 9

² Raporti i Institutit Demokratik të Kosovës, "Fushatë për paratë", nëntor 2017

RREGULLIMI LIGJOR NË LIDHJE ME FUSHATËN ZGJEDHORE

Korniza ligjore, e cila rregullon organizimin e fushatës zgjedhore në Kosovë përbëhet nga Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, Ligji për Zgjedhjet Lokale, Ligji për Financimin e Subjekteve Politike, Kodi Penal i Kosovës si dhe aktet nënligjore që rregullojnë çështjen e fushatës zgjedhore në Kosovë.³ Aktet nënligjore janë rregulla të cilat nxirren dhe miratohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për menaxhim të procesit zgjedhor, e të cilat kanë një rol të rëndësishëm në gjithë procesin zgjedhor.

Disa nga parimet ndërkombëtare në financimin e subjekteve politike, por edhe të fushatave zgjedhore janë: 1. Rregullat e vendosura për të ardhurat dhe kontributet; 2. Kufizimi i shpenzimeve në fushatë; 3. Fondet dhe subvencionet publike; 4. Deklarimi dhe transparenca; dhe 5. Zbatimi dhe Sanksionet.⁴

Të gjitha këto mund të gjenden në instrumentet ndërkombëtare si në vijim: 1. Komisioni i Venedikut, Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore (2002); 2. Komisioni i Venedikut, Udhëzime për Rregullimin e Partive Politike (2010); 3. Këshilli i Evropës, Rezoluta e Asamblesë Parlamentare 1516 (2001); 4. Këshilli i Evropës, Rekomandimi i Komisionit të Ministrave Rec (2003) 4; 5. Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, Komenti i Përgjithshëm nr. 25; 6. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Dokumenti i Kopenhagës 1990.⁵

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, është ligj shumë i rëndësishëm për procesin zgjedhor, duke përfshi edhe fushatën zgjedhore. Ky ligj përmban edhe Kodin e mirësjelljes për

subjekte politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët, me të cilin rregullon se si do të duhet vepronë subjektet politike, anëtarët dhe mbështetësit e tyre gjatë kohës së zgjedhjeve në të cilën përfshihet edhe koha e fushatës zgjedhore.⁶ Kodi i mirësjelljes në LZP ka për qëllim që të krijoj kushtet në të cilat votuesit e Kosovës do të ndiheshin të lirë që të zgjedhin përfaqësuesit e tyre përmes zgjedhjeve të lira, të drejta e mbi të gjitha të jenë të mirë informuar për atë çka ofrohet nga subjektet politike/kandidatët, duke garantuar një atmosferë të tolerancës demokratike, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.⁷ Ligjvënësi përmes këtij kreu tregon synimin e Kosovës për t'ia mundur sa më shumë qytetarëve që të informohen dhe të marrin pjesë në shpalljen e programeve politike, duke iu garantuar atyre që fushata do të zhvillohet në atmosferë të tolerancës ndaj subjekteve të tjera politike/kandidatëve, në paqe, pa gjuhë të urrejtjes apo thirrje për të sulmuar subjektin tjetër politik/kandidatin dhe në respektim të njëri tjetrit, duke e respektuar LZP-në dhe rregullativën tjetër në fuqi.

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, ka një kapitull të veçantë edhe për kufizim të shpenzimeve financiare të fushatës dhe deklarimin financiar me qëllimin e vetëm që të rregullohet tavani maksimal i shpenzimeve nga një subjekt politik/kandidat në periudhën e fushatës zgjedhore. LZP-ja rregullon edhe çështjen e deklarimit financiar pas përfundimit të procesit zgjedhor, afatet e deklarimit, mënyrën e deklarimit, auditimin e raporteve, informimin e publikut si dhe sanksionet për të gjitha rastet kur subjekti politik apo kandidati dështon t'i përmbushë ato.

³ Rregullativa ligjore e përmbledhur në ueb faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

⁴ Raporti i Institutit Demokratik të Kosovës, "Paratë në politikë", qershor 2017, Prishtinë, faqe 9

⁵ Ibid

⁶ Gazeta Zyrtare - Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës: (Qasur me 15.08.2018)

⁷ Gazeta Zyrtare - Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës: Neni 31 i ligjit. (Qasur me 15.08.2018)

Tutje, LZP-ja ka rregulluar mënyrën e njoftimit për ngjarjet politike, pra çfarë ju lejohet subjekteve politike që të organizojnë gjatë kohës së fushatës si dhe sanksionet në rastet kur subjekti politik nuk e ka përmbushur kriterin ligjor, ose ka dal jashtë ligjit..

Media në fushatë dhe gjatë fushatës zgjedhore, është një kapitull në kuadër të LZP-së, i cili i kushtohet Kodeve të mediave transmetuese dhe mediave të shkruara. LZP-ja obligon mediat në qasje të drejtë dhe të paanshme në kohën e fushatës dhe mbulimit mediatic të fushatës. Pikë kryesore është edhe rregulli i reklamimit politik në radio dhe televizion, duke kufizuar kohën e gjatësisë së reklamave. Po ashtu, me të rregullohet edhe paraqitja mediale në mediat e shkruara dhe reklamimi politik në ato media.

Ligj tjetër po aq i rëndësishëm për çështjen e fushatës zgjedhore është edhe Ligji për Zgjedhjet Lokale në Kosovë⁸. Ky ligj për çështjen e fushatës zgjedhore, financimin dhe kodin e mirësjelljes i referohet LZP-së, i cili është i aplikueshëm në këtë pjesë edhe për zgjedhjet lokale. Sipas nenit 15 i LZL-ja në Kosovë mutatis mutandis⁹ vlejnë rregullat e kreut V të LZP-së.

Një nga ligjet më të rëndësishme për fushatën zgjedhore dhe mënyrën e financimit të fushatës zgjedhore, por edhe të vet subjektit politik është Ligji për Financimin e Subjekteve Politike.¹⁰ Përmes këtij Ligji, Republika e Kosovës ka rregulluar mënyrat dhe kushtet e financimit, administrimin, mbikëqyrjen, transparencën dhe raportimin për shpenzimin e pasurisë dhe të ardhurave të subjekteve politike. Më konkretisht, Ligji në mënyrë specifike rregullon çështje të rëndësishme sa i përket financave dhe shpenzimeve të subjekteve politike në kohën e zgjedhjeve, e cila përfshinë fushatën zgjedhore.

Në nenin 10 janë vendosur kufizime sa i përket shumës së buxhetit që mund të ndajë shteti për financimin e fushatës zgjedhore në zgjedhjet lokale dhe ato qendrore, qofshin ato të rregullta apo të jashtëzakonshme. Kuvendi i Kosovës me propozim të Qeverisë së Kosovës për subjektet politike pjesëmarrëse në zgjedhje, ndan mjete nga Fondi për mbështetjen e subjekteve politike, të cilat nuk mund të kalojnë shumën e 0.05% të buxhetit të Kosovës. Nga këto mjete pjesën më të madhe prej 90% e përfitojnë subjektet politike të cilat kanë ulëse në Kuvend, dhe shuma ndahet në varësi të ulësive, ndërsa 10% që mbetet

ndahet proporcionalisht për subjektet politike, të cilat marrin pjesë në zgjedhje, e të cilat paraprakisht janë të certifikuar për ato zgjedhje nga KQZ-ja. Në pjesën e 10% ndahen mjete edhe për subjektet politike të posa regjistruara me qëllimin më të mirë që të mundësohet edhe atyre shpërfaqja/prezantimi i programit të tyre para qytetarëve votues.

Në zgjedhjet e fundit të parakohshme qendrore dhe ato lokale nuk është shpërndarë fondi prej 10% për subjektet e tjera politike të regjistruara dhe të certifikuar nga KQZ për të kandiduar në zgjedhje. Mosndarja e fondeve u kritikua edhe në raportin e Misionit Vëzhgues të Bashkimit Evropian, duke potencuar kufizimin emundësive për fushatë për partitë më të vogla.¹¹

Aktet nënligjore zënë një vend të rëndësishëm në procesin zgjedhor në Republikën e Kosovës. Më konkretisht, KQZ ka miratuar një numër të konsiderueshëm të "rregullave zgjedhore", me anë të së cilave rregullohen aspekte të caktuara të procesit zgjedhor. Disa nga Rregullat kryesore të miratuara nga KQZ-ja janë: [Rregulla nr. 01/2013](#) për regjistrimin dhe veprimin e partive politike; [Rregulla nr. 08/2013](#) mbi certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre; [Rregulla nr.12/2013](#) mbi kufizimin e shpenzimeve të fushatës dhe deklarimi financiar; [Rregulla nr.13/2013](#) për Fushatën e zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike; [Rregulla nr. 14/2015](#) Financimi i subjekteve politike dhe sanksionet si dhe rregulla të tjera të cilat nuk lidhen me financimin e subjektit politik apo me financimin e fushatës zgjedhore.

Parandalimi i keqpërdorimeve dhe i manipulimit të procesit zgjedhor ka shtyrë autoritetet shtetërore që të parashohë vepra penale, të cilat mund të kryhen vetëm në kohë të zgjedhjeve. Në Kodin Penal të Kosovës¹² është paraparë një kapitull i veçantë për veprat penale kundër të drejtës së votimit. Ky kapitull i Kodit përmban gjithsejtë 11 nene të cilat sanksionojnë dhe përshkruajnë veprimet e ndaluar gjatë një procesi zgjedhor, përfshi edhe fushatën zgjedhore. Veçanërisht neni 211 i Kodit Penal sanksionon pengimin e kandidatit për realizimin e veprimtarive në fushatë zgjedhore. Dënimi për kryesit e kësaj vepre penale është dënim me gjobë ose dënim me burg deri në 1 vit. Në rastet kur kandidatët janë kanosur apo është përdor forcë kundër tyre, atëherë dënimi me burg për kryesin jepet nga 6 muaj deri në 3 vite.

⁸ [Gazeta Zyrtare - Ligji për Zgjedhjet Lokale](#) (qasur me 15.08.2018)

⁹ Përshtatshmërisht – aplikohet në rastet kur një çështje është e rregulluar me ligj special dhe nuk është e nevojshme të rregullohet edhe me ligj tjetër, por ligji i regerohet ligjit special në rastet e nevojës për aplikim të normave të tilla.

¹⁰ [Gazeta Zyrtare - Ligji për Financimin e Subjekteve Politike](#) (qasur me 15.08.2018)

¹¹ Misioni Vëzhgues i Zgjedhjeve të Bashkimit Evropian, [Raporti mbi zgjedhjet parlamentare 2017](#), f. 21

¹² [Gazeta Zyrtare - Kodi Penal i Republikës së Kosovës](#), Kapitulli XVIII, Nenet 210 – 220. Shih: (qasur me 15.08.2018)

KUFIZIMET FINANCIARE GJATË FUSHATËS DHE DEKLARIMI FINANCIAR

Subjektet politike për realizimin e fushatës zgjedhore duhet të kenë mjete materiale dhe përkrahje nga buxheti i shtetit, anëtarësia, kontributet dhe të ardhurat nga aktivitetet e tyre të përcaktuara me ligj. Financimi i fushatave zgjedhore të subjekteve politikeve mbështetet me 0.05% të vlerës së buxhetit vjetor të shtetit, ndërsa LPZ-ja në Kosovë i ka lënë mundësi Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që ta përcaktoi rregullin se sa do të jetë shpenzimi i subjekteve politike maksimalisht në zgjedhjet që mbahen. Rregulli publikohet 5 ditë pas shpalljes së ditës së zgjedhjeve. E rëndësishmë është që asnjë subjekt politik nuk ka të drejtë ta tejkaloj kufizimin e shpenzimeve për fushatën zgjedhore që caktohet nga rregulla e KQZ-së.¹³ Hera e fundit kur KQZ-ja ka ndërhyrë në këtë rregullore ka qenë korriku i vitit 2013. Që nga ajo kohë kjo rregullore nuk është ndryshuar apo specifikuar me vlerë tjetër e tavanit të shpenzimit apo rritje të shpenzimeve për një votues.

Maksimumi i shpenzimeve të fushatës mbështetet në numrin e përgjithshëm të votuesve të regjistruar në listën e votuesve, e që është 0.50 Euro cent për votues.¹⁴

Në zgjedhjet e fundit kufizimi apo maksimumi që një subjekt politik mund të shpenzonte gjatë fushatës zgjedhore ishte 942,753.00 euro (nëntqind e dyzetë e dy mijë e e shtatëqind e pesëdhjetë e tre euro). Megjithatë rregulla mbi kufizimin e shpenzimeve të fushatës dhe deklarimit financiar parasheh kompetenca të zgjeruara për KQZ-në në rastet kur komuna ka më pas se 5000 banorë. Në këto raste KQZ-ja mund të vendos rregull të veçantë në lidhje me shpenzimet e fushatës.¹⁵ Shpenzimet sipas LQP-së janë të gjitha shpenzimet e fushatës pavarësisht nëse është mall apo shërbim i shpenzuar

për fushatë. Ndërsa subjekti politik nuk mund të pranojë çfarëdo kontributi përveç ashtu siç është e rregulluar me Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike.

Rregulli 12/2013 mbi kufizimin e shpenzimeve të fushatës dhe deklarimit financiar parasheh 6 muaj kohë para fillimit të fushatës zgjedhore prej kur subjektet politike mund të fillojnë mbledhjen e fondeve nga personat të tjerë për shpenzimet e fushatës zgjedhore.¹⁶

Po ashtu është paraparë që të gjitha shpenzimet apo shërbimet për fushatën zgjedhore dhe që kanë qëllim fushatën, pavarësisht a janë bërë në kohën e fushatës apo para saj, duhet të llogariten si shpenzime të fushatës dhe të raportohen si të tilla.¹⁷

Rregullimi i tillë ligjor është masë parandaluese për subjektet politike që aktivitetin e tyre të blerjes së shërbimeve apo shpenzimeve për fushatë zgjedhore ta bëjnë paraprakisht dhe të krijojnë avantazh me subjektet e tjera politike. Po ashtu koha prej 6 muajsh para fillimit të fushatës zgjedhore, sipas rregullit është kohë e mjaftueshme për mbledhjen e fondeve për fushatë zgjedhore.

Në anën tjetër subjekti politik ka detyrime ligjore për secilin nga shpenzimet e realizuar gjatë fushatës. Fillimisht subjekti duhet të mbajë evidenca të sakta se ku dhe si janë shpenzuar fondet e më pas të përpilojë një raport financiar. Raporti është i obliguar për të gjitha subjektet politike që janë certifikuar për të marrë pjesë në zgjedhje. Pra nuk ka përjashtime edhe nëse subjekti politik që ka marrë pjesë në zgjedhje e nuk ka


13 [Rregulla nr.12/2013](#) mbi kufizimin e shpenzimeve të fushatës dhe deklarimit financiar, Neni 1 paragrafi 1.1

14 [Rregulla nr.12/2013](#) mbi kufizimin e shpenzimeve të fushatës dhe deklarimit financiar, Neni 3 paragrafi 3.1

15 [Rregulla nr.12/2013](#) mbi kufizimin e shpenzimeve të fushatës dhe deklarimit financiar, Neni 3 paragrafi 3.1 dhe 3.2

16 [Rregulla nr.12/2013](#) mbi kufizimin e shpenzimeve të fushatës dhe deklarimit financiar, Neni 1 paragrafi 1.3

17 [Rregulla nr.12/2013](#) mbi kufizimin e shpenzimeve të fushatës dhe deklarimit financiar, Neni 3 paragrafi 1.4



Po ashtu është paraparë që të gjitha shpenzimet apo shërbimet për fushatën zgjedhore dhe që kanë qëllim fushatën, pavarësisht a janë bërë në kohën e fushatës apo para saj, duhet të llogariten si shpenzime të fushatës dhe të raportohen si të tilla.

bërë asnjë lloj fushate dhe sipas nenit 40 të LZP-së, edhe këto subjekte detyrohen të raportojnë. Raporti i Publikimit Financiar për Fushatën përfshinë periudhën 90 ditëshe para fillimit të zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve. Në raport duhet të përfshihen shpenzimet e të gjithë subjektit politik (degët dhe pjesët tjera të subjektit). Ditët numërohen si ditë kalendarike, ndërsa raporti duhet të dorëzohet jo më vonë se dyzetë e pesë (45) ditë kalendarike pas ditës së zgjedhjeve.¹⁸

Standardet evropiane të raportimit të financiar pas zgjedhjeve kanë një afat më të shkurtër ligjor dhe atë 30 ditë nga përfundimi i zgjedhjeve. Raportimi obligohet të bëhet jo vetëm për subjektin politik, por edhe kandidatët individual si dhe të gjithë listën e kandidatëve.¹⁹

Kjo pikë është edhe një ndër standardet që KDI-ja rekomandon në ndryshimin e legjislacionit të zgjedhjeve që lidhet me financimin dhe shpenzimet e fushatës zgjedhore, ashtu që pjesë e raportimit financiar të jenë edhe shpenzimet që kandidatët kanë gjatë fushatës (komplet listat e kandidatëve) por edhe kandidatët individual.

Një gjë shumë e rëndësishme e që lidhet me maksimumin e shpenzimeve të subjektit politik është edhe raportimi financiar i kandidatëve. Praktikisht në Kosovë subjektet politike raportojnë vetëm shpenzimet që ata kanë realizuar si subjekte politike, por jo edhe shpenzimet, të cilat i kanë bërë gjatë fushatës kandidatët e subjektit politik. Mungesa e të dhënave të tilla ose mungesa e kërkesës ligjore për një gjë të tillë, ka bërë që subjektet politike në shpenzimet e deklaruara për fushatë zgjedhore të mos i përfshijnë shpenzimet e kandidatëve të subjektit politik. Mangësia ligjore ka bërë që subjektet politike ta shfrytëzojnë maksimumin e shpenzimeve të lejuara për fushatë zgjedhore, ndërsa kandidatët kanë po ashtu një sasi të pa kufizuar të mjeteve materiale apo shërbimeve, me të cilat aktivistët mund të kryejnë punë në emër të kandidatit.

¹⁸ Gazeta Zyrtare - Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës Neni 40 paragrafi 40.1

¹⁹ Komisioni i Venecias dhe OSBE/ODIHR, Udhëzimet për rregullimin e partive politike, 2010

PËRMBAJTJA E RAPORTEVE FINANCIARE

Raporti financiar i subjekteve politike për fushatë duhet të përmbajë të dhëna të sakta siç kërkohet me LZP-në. Për t'u pranuar si raport nga Zyra e KQZ-së për Regjistrim dhe Certifikim të Subjekteve Politike, ai duhet t'i përmbaj të dhënat si më poshtë²⁰:

- 1 Të ardhurat e subjektit politik për periudhën raportuese, përfshi burimin dhe datën e gjitha kontributeve me para të gatshme;
- 2 Të gjitha shpenzimet, përfshirë shpenzimet e fushatës, të bëra nga subjekti gjatë periudhës raportuese; dhe
- 3 Bilancin mbi pasuritë, detyrimet dhe barazimet e subjektit nga dita e parë deri në ditën e fundit të periudhës së raportimit.

Për të gjitha shpenzimet e subjektit politik gjatë periudhës raportuese, subjekti duhet t'i paraqes dëftesat (faturat) për secilën pagesë administrative të paguar. Raportit financiar duhet t'i bashkëngjiten edhe dëftesat (faturat) për secilin shpenzim të paguar nga subjekti politik. Por, në rastet kur subjekti politik dështon ta sjell në Zyrën për Regjistrim dhe Certifikimin e Subjekteve Politike, raportin financiar të fushatës apo atë ta sjell të mangët atë, atëherë Zyra sipas detyrës zyrtare mund të paraqes ankesë kundër subjektit politik në PZAP për shkeljet të nenit 40 paragrafi 40.1 të LZP-së . Në data të ndryshme²¹ i jemi qasur uebfaqes zyrtare të KQZ-së, për të parë nëse janë publikuar raportet financiare të shpenzimeve në dy fushatat zgjedhore. Në këtë faqe nuk është paraqitur asnjë e dhënë mbi shpenzimet financiare të subjek-

teve politike për dy palë zgjedhjet fundit: ato të parakohshme qendrore dhe zgjedhjet lokale.²² Në anën tjetër, i jemi qasur në data të ndryshme edhe uebfaqes zyrtare të PZAP-së²³, për të parë nëse ka ndonjë ankesë nga Zyra në lidhje me mos deklarimin e raporteve financiare nga subjektet politike, por që nga marsi i 2018 PZAP-ja nuk e ka të regjistruar as një lëndë të re.²⁴

Publiku nuk ka njohuri nëse subjektet politike kanë paraqitur me kohë raportet financiare të shpenzimeve të të dy fushatave të fundit, dhe nuk dihet nëse ndonjë raport financiar ka mbetur pa u paraqitur apo ka mungesa në raportim.

Detyrimi i paraqitjes së raportit financiar për shpenzimet e fushatës nuk përfundon me dorëzimin e raportit tek Zyra. Subjekti politik ka edhe detyrime të tjera ligjore në aspektin financiar, psh. për çdo pagesë mbi shumën 100 euro, fatura duhet të ruhet deri në 7 vite së bashku me raportin financiar dhe të gjitha detajet e tjera përfshirë edhe librat e mbajtjes së llogarive, shërbimet bankare për të gjitha llogaritë, dokumentet e pasurisë, pronësisë apo posedimit, kontratat e lidhura për qira apo blerje të pasurive të luajtshme apo paluajtshme, të gjitha kontributet në subjekt pavarësisht kohën se kur janë bërë.²⁵

Përcaktimi i tillë ligjor është bërë për t'ia pamundësuar subjektit politikm zhdukjen e gjurmëve të shpenzimeve gjatë fushatës për një kohë të gjatë. Prokuroria e shtetit gjatë gjithë kësaj periudhe kohore mund të kërkojë hetim për mënyrën e financimit dhe t'i kontrollojë raportet e pa audituara dhe të audituara të subjektit politik. Nëse gjenden prova, atëherë

20 [Gazeta Zyrtare - Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës](#) Neni 40 paragrafi 40.2

21 Me datën 15.08.2018; 02.11.2018; 29.11.2018 dhe 04.12.2018

22 [Ueb faqja e KQZ](#)

23 Me datën 15.08.2018; 02.11.2018; 29.11.2018 dhe 04.12.2018

24 [Ueb faqja e PZAP](#)

25 [Gazeta Zyrtare - Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës](#) Neni 40 paragrafi 40.6

prokurori do të mund të ngrisë aktakuzë për zyrtarët e subjektit politik për keqpërdorime financiare që janë bërë me fondin të cilin subjekti politik e merr nga taksat e qytetarëve. Deri më sot nuk ka ndonjë dhënë publike nëse është zhvilluar ndonjë hetim në lidhje me shpenzimet esubjekteve politike gjatë kohës së fushatës zgjedhore. Askush nga Prokuroria e Shtetit nuk është marrë me çështjen e financimit të fushatave dhe kufizimit ligjor që përcaktohet me LZP-në. Hetimi i mënyrës së financimit të subjekteve politike dhe shumat e pranuar për fushatën apo edhe shërbimet e kryera qoftë nga individët apo kompanitë në të mirë të subjektit politik dhe më pas paraqitja e të hyrave dhe shpenzimeve në raportin përfundimtar të fushatës mund të ishin pikënisje e mirë për luftimin e shpërlarjes së parasë dhe korrupsionit por edhe të blerjes së votave.

Kontributet e bëra duhet të regjistrohen dhe të mbahen sipas procedurës ligjore. Regjistrimi i kontributit përfshinë marrjen e të dhënave personale, si: emrin e plotë, adresën, numrin e ID ose pasaportës të secilit kontribues, vlerën e kontributit, datën e secilit kontribut, dhe emrin e personit që e ka pranuar kontributin.²⁶

Subjektet politike obligohen që të kenë zyrtarë për financa, ndërsa shteti përmes ligjit ka marrë obligim që në momentin kur këta zyrtar emërohen t`i uofroj trajnim për llogaritjen dhe auditimin. Zyrtarët mund t`i shmangen trajnimit nëse dëshmojnë se kanë përvojë dhe ekspertizë të mjaftueshme dhe se për ta, një trajnim i tillë nuk është i nevojshëm.²⁷

Një gjë që është parë dhe kritikuar një kohë shumë të gjatë si nga Shoqëria Civile po ashtu edhe Misionet ndërkombëtare në Kosovë në lidhje me financimin e subjekteve politike është mospublikimi i raporteve financiare të fushatave në uebfaqet e subjekteve politike. E njëjta gjendje është edhe me raportet financiare vjetore për subjektin. As këto raporte nuk prezantohen në uebfaqet e shumë subjekteve politike. LZP-ja nuk kërkon që subjektet politike t`i paraqesin raportet e tyre financiare në uebfaqe, por standardet e transparencës kërkojnë që raportet financiare të jenë të qasshme për publikun. Subjekti politik përtej kërkesës ligjore e në dobi të transparencës dhe llogaridhënies do të duhej që menjëherë pas mbarimit të procesit zgjedhor, në uebfaqen zyrtare ta paraqes raportin financiar të të hyrave dhe shpenzimeve të bëra gjatë fushatës. Një gjë e njëjtë do të ishte mirë të bëhej edhe për shpenzimet që

kandidatët për deputetë/anëtar të Kuvendeve dhe kandidatët për kryetar të komunës të raportojnë në uebfaqen e subjektit politik që i përkasin, të gjitha financimet dhe shpenzimet që ata kanë pasur gjatë zgjedhjeve. Kur flitet për financimet dhe shpenzimet e kandidatëve, ireferohemi financimeve dhe shpenzimeve personale, jashtë buxhetit të subjektit politik që kandidati bënë gjatë fushatës. Normalisht që standardi tjetër, sipas KDI –së është edhe ai i transparencës së financave të subjekteve politike. Pra paraqitja e raporteve financiare në uebfaqen e subjektit politik.

Raporti i BE-së për zgjedhjet e përkohshme parlamentare të 2017-ës në Kosovë thekson mungesën e transparencës në financat e subjekteve politike, duke thënë se: Shumica nuk i publikojnë raportet gjithëpërfshirëse të fushatës në faqet e tyre në internet, duke iu referuar një dispozite ligjore që kërkon publikimin vetëm pasi që të jetë kryer auditimi. Për më tepër, mungesa e shqyrtimit ngritë pyetje rreth shpenzimeve përtej kufizimeve të përcaktuara me ligj, si dhe pranimit të donacioneve të paregjistruara, veçanërisht ato që u drejtohen kandidatëve individualë²⁸.

²⁶ [Gazeta Zyrtare - Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës](#) Neni 40 paragrafi 40.6

²⁷ [Gazeta Zyrtare - Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës](#) Neni 40 paragrafi 40.7

²⁸ Misioni Vëzhgues i Zgjedhjeve të Bashkimit Evropian, [Raporti mbi zgjedhjet parlamentare 2017](#), f. 22

PRAKTIKAT DHE STANDARDET MË TË MIRA NË FINANCIMIN DHE SHPENZIMET E FUSHATËS ZGJEDHORE

Përkundër faktit se Kosova ka legjislacion të konsoliduar që e rregullon fushatën zgjedhore dhe mënyrën se si duhet të bëhet raportimi financiar, trendet në botë tregojnë për avancim të mëtejshëm të transparencës që lidhen me çështjet e fushatës dhe financimit të fushatave zgjedhore.

Për t'i shmangur donacionet e paregjistruara për subjektin politik dhe kandidatët individual, KDI-ja rekomandon që transparenca e subjekteve politike të avancohet dhe mbështetet përmes ndryshimeve ligjore dhe zbatimit efikas të tyre. Më konkretisht, subjektet politike duhet të kenë vetëm një llogari bankare online, ndërsa të kenë edhe një nënlllogari të veçantë, po ashtu online, që shfrytëzohet vetëm gjatë fushatës zgjedhore.

Nënlllogaria e shfrytëzueshme vetëm në kohë fushatash do të ishte e hapur për të gjithë individët edhe personat juridik që të kontribuojnë financiarisht për subjektin politik. Në anën tjetër, subjekti politik, të gjitha blerjet dhe shpenzimet do t'i realizonte përmes kësaj nënlllogarie bankare, ndaj edhe për auditorët do të ishte shumë më i lehtë auditimi financiar i subjektit, teksa publiku do ta kishte më të lehtë ta dij kush është donatori i subjektit politik dhe sa para ka mbledhur subjekti.

Nënlllogaria do t'i shërbente edhe rritjes së transparencës dhe llogaridhënies fillimisht brenda për brenda subjektit politik, pastaj anëtarësisë, kandidatëve e simpatizantëve dhe në

fund edhe vet publikut. Anëtarët e subjektit politik, përfshirë këtu edhe kandidatët do ta kuptonin se ku janë harxhuar mjetet financiare të subjektit dhe ku janë destinuar shërbimet e subjektit politik. Për publikun do të ishte shumë e rëndësishme pjesa e shpenzimeve të pjesës së parasë publike por normalisht që publiku çdo herë dëshiron të dijë se kush janë personat që kanë ofruar para apo shërbime për subjektin politik.

KDI-ja rekomandon që llogaria kryesore dhe nënlllogaria e subjektit të jenë publike në kohë reale (online) në uebfaqen e Zyrës për Regjistrim dhe Certifikim të subjekteve politike (në kuadër të KQZ-së). Bërja publike në uebfaqe e llogarive bankare në shtetet si Republika e Çekisë, ka ndihmuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së subjekteve politike atje, praktikë, e cila është duke u përhapur edhe nga vendet e tjera të Bashkimit Evropian.

Transparenca në financimin dhe në shpenzimet e fushatës si parim bazë i qeverisjes së mirë do ta ndihmonte publikun të kuptojë se si dhe nga kush mbështeten fushatat zgjedhore të subjekteve politike, dhe më tepër si dhe sa këto të fundit i shpenzojnë dhe raportojnë këto fonde.

Në rastin e Republikës Çeke është krijuar një komision (organ shtetëror) i veçantë i cili është i pavarur, i pranon raportet financiare nga subjektet politike dhe i kontrollon ato. Ligji ka dety-

çështjen e reformës zgjedhore përfshi edhe shpenzimet e fushatës dhe hapjen e llogarive bankare për këtë çështje.³¹

Nëse do të kemi ndryshim të ligjit atëherë, ai do të prekte KQZ-në si institucioni i vetëm që merret me organizimin dhe menaxhimin e zgjedhjeve në vend. Ndaj Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim do t'i shtoheshin kompetencat, sikurse edhe stafit që do të mbulonte pjesën e kontrollit financiar të subjekteve politike në kohë reale. Normalisht që kjo përfshin një kosto financiare pasi që ai do të jetë një institucion të ri. Në anën tjetër, implikimi shtesë do të ishte edhe definimi i organit të cilit do t'i raportonte ky institucion, sikurse edhe pavarësia e tij nga politika.

Mënyra më e mirë do të ishte që institucioni apo zyra të ishte e pavarur dhe t'i raportonte Kuvendit të Kosovës për të gjitha çështjet. Stafi i zyrës duhej të ishte profesional dhe të punonte në rritjen e nivelit të transparencës e llogaridhënjes tek subjektet politike. Njëkohësisht do të ndihmonte edhe në rritjen e standardeve për zgjedhje të lira e demokratike.

Duke parë nevojën e Kosovës për të zbatuar praktikatat e mira dhe që nuk parashihen me ligj, atëherë zgjidhje e vetme mbetet vendosja e standardeve evropiane në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme pas reformës zgjedhore, apo pa reformë zgjedhore vetëm me amendamente të reja.

Instituti Demokratik i Kosovës së bashku me Transparency International Çekia propozon **5 Standarde** që do ta rrisnin transparencën dhe llogaridhënien e subjekteve politike para publikut, përtej detyrimeve ligjore të parapara.

- 1 **Publikimi i emrave të të gjithë anëtarëve të shtabit zgjedhor** të subjektit politik, caktimi dhe publikimi i emrit të menaxherit financiar për fushatën. Publikimi i emrave të anëtarëve të shtabit zgjedhor (dhe shtabeve në degë regjionale) të subjektit politik dhe emrit të financierit të emëruar vetëm për fushatë do ta rriste transparencën e subjektit politik përballë publikut.
- 2 **Detyrimi ligjor që i obligon subjektet politike për hapjen e llogarive financiare** për shpenzimet e fushatës zgjedhore. Hapja e llogarive nënkupton bërjen publike e të qasshme në kohë reale përmes portalit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ndonjë portali tjetër apo vet portalit të subjektit politik/ kandidatit.

- 3 **Publikimi i financave të secilit kandidat në fushatë.** Secili subjekt politik duhet t'i publikoi dhe duhet t'i detyroi të gjithë kandidatët që të raportojnë në subjektin me të cilin kandidojnë. Të dihet cili është kontributi financiar i tyre në fushatën e subjektit politik, me të dhënat se nga e ka financuar kandidati fushatën e tij personale. Kandidatët mund të detyrohen sipas që sipas LZP-së të paraqesin raporte financiare të shpenzimeve të fushatës së tyre individuale në subjektin politik, e më pas subjektin politik t'i inkorporoj ato në llogarinë qendrore si të hyra dhe shpenzime. Pjesëmarrja financiare e kandidatëve në fushatë duhet të regjistrohet edhe në raportin financiar të fushatës.
- 4 **Publikimi i të dhënave edhe për subjektet juridike (kompanitë)** që japin donacione për subjektin politik, dhe jo vetëm pronarëve. Me këtë ndryshim ligjor publiku do ta kuptonte se cili është pronari i fundit që ka dhënë donacionin për subjektin politik, kjo sidomos tek kompanitë që kanë shumë pronarë, të cilët mbahen të fshehur. Po ashtu subjektet politike duhet të paraqesin në raportin e tyre financiar edhe shërbimet që kompanitë i kanë bërë për subjektin e që ato shërbime mund të konvertohen në vlera monetare.
- 5 **Publikimi i kalendarëve të të gjitha ngjarjeve, të cilat do t'i realizoj subjektin politik gjatë fushatës.** Këtu duhet të përfshihen edhe ngjarjet të cilat janë organizuar apo do të organizohen nga kandidatët pa përkrahjen e subjektit politik.

31 KDI ka komunikuar dhe ka kërkuar takime edhe me subjektet e tjera parlamentare përfshijë edhe komunitetin pakicë serb por që nuk kanë pranuar të takohen meqë nuk kanë qëndrime.



TAKIMI ME SUBJEKTET POLITIKE DHE REZULTATET E ANKETËS

Instituti Demokratik i Kosovës gjatë muajit korrik dhe gusht të vitit 2018 ka takuar ndaras subjektet politike: Lidhja Demokratike e Kosovës, Partia Demokratike e Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Nisma Social Demokrate, Aleanca Kosova e Re dhe Alternativa për çështjen e reformës zgjedhore përfshi edhe shpenzimet e fushatës dhe hapjen e llogarive bankare për këtë çështje. KDI-ja ka komunikuar dhe ka kërkuar takime edhe me subjektet e tjera parlamentare përfshirë edhe ato të komunitetit serb, por të njëjtit nuk kanë pranuar të takohen, duke deklaruar se nuk kanë qëndrim lidhur me këto çështje.

Po ashtu, KDI-ja ka përgatitur një pyetësor prej 21 pyetjesh që kanë të bëjnë me reformë zgjedhore në përgjithësi, për ta matur disponimin e subjekteve politike se a janë të gatshme ta bëjnë reformën dhe cilat do të ishin ndryshimet që ato subjekte do t'i shtynin përpara që të bëhen më pas pjesë e ligjit të zgjedhjeve. Të gjitha pyetjet e pyetësorit paraprakisht janë parashtruar edhe në takimet individuale me subjektet politike. Subjektet kanë dhënë qëndrimet e tyre në lidhje me çështjen e reformës zgjedhore në përgjithësi. KDI-ja ju ka dhënë afat prej më shumë se 15 ditësh subjekteve politike që ka takuar që të përgjigjen në pyetësori, por jo të gjitha subjektet politike kanë kthyer përgjigje.

Pyetësori u është dërguar 8 subjekteve politike, ndërsa KDI-ja ka pranuar përgjigje vetëm nga 5 subjekte politike. Subjektet politike Lidhja Demokratike e Kosovës, Partia Social Demokrate dhe Alternativa nuk janë përgjigjur në pyetësorin e KDI-së. Ajo çka është vërejtur në përgjigjet e pranuar nga subjektet politike, është se ka ndryshime në mes përgjigjeve që janë dhënë në takim për çështje të caktuara dhe përgjigjeve me shkrim nga subjekti politik. Poashtu ka raste kur subjektet nuk janë përgjigjur fare në disa pyetje.

Për qëllime të kësaj analize, ne do analizojmë vetëm përgjigjet e pyetjeve që lidhen me shpenzimet e subjekteve politike që prekin reformën zgjedhore. Në tabelën në vijim do t'i paraqesim rezultatet e përgjigjeve/anketës.

Ajo çka është vërejtur në përgjigjet e pranuar nga subjektet politike, është se ka ndryshime në mes përgjigjeve që janë dhënë në takim për çështje të caktuara dhe përgjigjeve me shkrim nga subjekti politik.


















	Llogari online	Emrat e anëtarëve të shtabit	Emrat e donatorëve (personat fizik dhe juridik)
AAK			
AKR	 Llogari online		
LVV	 Llogari online		 bashkë me buxhetin
NISMA SD	 Llogari online		 Nëse e kërkon ligji dhe varësisht nga shumata e donacionit
PDK	 nëse kërkohet me ligj		 Nëse e kërkon ligji

Tabela e rezultateve të anketës.³²


























Secila nga subjektet politike kanë shprehur qëndrimet e veta në lidhje me pyetjet e drejtuara, dhe përgjigjet i kanë të ngjashme në gati të gjitha pyetjet. Por ajo që është shumë e rëndësishme është se shumica e këtyre subjekteve politike nuk i kanë të publikuara raportet e tyre financiare në uebfaqet zyrtare, përjashtojë Lëvizjen Vetëvendosje, e cila e ka të

publikuar edhe raportin e pa audituar nga zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2017.³³ Në anën tjetër Lidhja Demokratike e Kosovës i ka në uebfaqe raportet financiare nga viti 2014 dhe 2016, por asnjë raport financiar të ri nga fushata e fundit zgjedhore.³⁴

³² Anкета me subjektet politike

³³ [Raporti financiar i LVV](#) qasur për herë të fundit me datën 05.12.2018

³⁴ [Uebfaqja e LDK](#) e qasur për herë të fundit me datën 05.12.2018

Publikimi i kalendarit	Publikimi i buxhetit me pjesën se nga është financiar	Kadidatët të deklarojnë financimin e tyre	Auditimi	A kanë vullnet SP që të aplikojnë ndonjëherë nga pyetjet e mësipërme edhe nëse nuk kërkohet me ligj
			 Auditorë të pavarur	
		 Nëse e kërkon ligji	 Institucion i pavarur /Zyra Kombëtare e Auditorit	 vetëm nëse e kërkon ligji
		 Nëse e kërkon ligji	 Zyra Kombëtare e Auditorit apo Agjensioni Kundër Korrupsionit	 Nuk është përgjigjur
		 Nëse e kërkon ligji	 Zyra Kombëtare e Auditorit	 Janë të hapur për ndryshime
 Nëse e kërkon ligji	 sipas ligjit	 Nëse e kërkon ligji	 Auditor të pavarur nën mbikqyrjen e KQZ-së	

Partia Demokratike e Kosovës³⁵ dhe Aleanca Kosova e Re³⁶ nuk kanë asnjë raport financiar në uebfaqet e tyre. Kurse Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës³⁷ dhe Nisma Social Demokratike³⁸ janë dy subjektete politike që nuk i kanë aktive uebfaqet e tyre.

Përkundër faktit se subjektet tona politike në përgjigjet e tyre janë shprehur për një transparencë më të madhe, në realitet ato as raportet për shpenzimet financiare nuk i paraqesin në uebfaqet e tyre.

35 [Ueb faqja e PDK](#) e qasur për herë të fundit me datën 05.12.2018

36 [Ueb faqja e AKR](#) e qasur për herë të fundit me datën 05.12.2018

37 [Ueb faqja e AAK](#) e qasur për herë të fundit me datën 05.12.2018

38 [Ueb faqja e NISMA](#) SocialDemokrate e qasur për herë të fundit me datën 05.12.2018



AUDITORI PËR FUSHATË

Auditori i fushatës nënkupton organizatën e cila do të auditojë shpenzimet e fushatës zgjedhore të subjektit politik. Zyra për Certifikimin e Subjekteve Politike ka të drejtë të auditojë secilin raport të publikimit financiar të fushatës apo formular të publikimit financiar të kandidatit.³⁹

Subjektet politike obligohen që të bashkëpunojnë me Auditorin e fushatës dhe t'i ofrojnë atij qasje të plotë e pa pengesa në regjistrat financiar të subjektit.⁴⁰ Tutje auditori pas realizimit të auditimit do të paraqet rezultatet paraprake të auditimit përfshi listën e gabimeve dhe lëshimeve të dukshme. Këto rezultate paraprake i dërgohen organit më të lartë të subjektit politik në periudhën prej 45 ditësh nga dita e fillimit të auditimit dhe jo më vonë se 4 muaj pas zgjedhjeve.⁴¹ E subjekti politik pas pranimit të këtij raporti ka për obligim që brenda 15 ditësh të korrigjoj gabimet dhe të japë sqarim për gabimet ose lëshimet e identifikuar nga auditori i fushatës.⁴²

Pasi që Auditori i fushatës i pranon nga subjekti politik ndryshimet dhe arsyetimin, e përgatit një raport përfundimtar të auditimit dhe e dorëzon në KQZ, pastaj te organi më i lartë ekzekutiv i subjektit politik. Afati për dorëzimin e raportit përfundimtar është 15 ditë pas përgjigjeve nga subjekti politik. Raporti përfundimtar i Auditorit të fushatës identifikon çdo gabim ose lëshim në raportin financiar duke përfshi edhe sqarimin e subjektit politik.⁴³

Nëse subjekti politik dështon në paraqitjen e raporti financiar të fushatës sipas LZP-së atëherë KQZ-ja ka të drejtë që ta ngarkojë subjektin politik me pagesa administrative, të cilat pagesa mëpas shkojnë në buxhetin e Kosovës.⁴⁴ Subjektit politik i lejohet e drejta e ankesës në vendimin e KQZ-së dhe atë në afat prej 5 ditëve të punës pas njoftimit mbi vendimin. Ankesa mund të dërgohet në Gjykatën Themelore në departamentin për çështje administrative.⁴⁵ Gjykata Themelore si shkallë e parë në këtë çështje nuk mund të shqiptoj sanksione në lidhje me çështjen që është subjekt i pagesës administrative. Subjekti politik i cili pas kundërshtimeve që i bënë vendimit të KQZ-së në të gjitha instancat gjyqësore dhe vendimi i KQZ-së mbetet i pa ndryshuar nga Gjykatat atëherë vendimi i KQZ mbetet në fuqi dhe merr formën e prerë, e subjekti politik duhet që të bëjë pagesën dhe dëftesën e pagesës duhet ta paraqes tek Zyra për Regjistrimin dhe Certifikimin e Subjekteve Politike.⁴⁶

39 [Gazeta Zyrtare - Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës](#) Neni 41 paragrafi 41.1 dhe 41.2
 40 [Gazeta Zyrtare - Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës](#) Neni 41 paragrafi 41.4
 41 [Gazeta Zyrtare - Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës](#) Neni 41 paragrafi 41.5
 42 [Gazeta Zyrtare - Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës](#) Neni 41 paragrafi 41.6
 43 [Gazeta Zyrtare - Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës](#) Neni 41 paragrafi 41.7
 44 [Gazeta Zyrtare - Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës](#) Neni 42 paragrafi 42.1
 45 [Gazeta Zyrtare - Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës](#) Neni 42 paragrafi 42.3 dhe 42.4
 46 [Gazeta Zyrtare - Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës](#) Neni 42 paragrafi 42.5

PËRFUNDIM

Raportimi financiar i të hyrave dhe i shpenzimeve gjatë fushatës zgjedhore dhe transparenca e të hyrave dhe shpenzimeve janë çështje thelbësore, ndaj duhet të jenë prioritet për subjektet politike. Transparenca në çështjet financiare është një përkushtim shtesë që subjekti politik për interes të publikut në lidhje me punën që subjekti politik e zhvillon.

Vite me radhë në Kosovë është paralajmëuar zbatimi i një reforme të mirëfilltë zgjedhore, por gjithçka ka përfunduar në nivelin e deklaratave politike. Zakonisht tema e reformës është hapur disa ditë para zgjedhjeve dhe ka përfunduar saherë gjatë fushatave zgjedhore. Pjesë e reformës zgjedhore do të duhej të ishte edhe ngritja e transparencës financiare të subjekteve politike duke përfshi standardet e transparencës financiare të cilat zbatohen në vendet e Bashkimit Evropian.

Llogaritëe qasshme bankare në ueb faqe të KQZ-së qëdo t'i mundësonin publikut t'i shohë në kohë reale të gjitha transakcionet bankare të subjektit politik, është një hap crucial në ngritjen e nivelit të transparencës së subjekteve politike përballë votueseve dhe publikut. Lidhur me këtë propozim, KDI-ja propozon të merret për bazë modeli i Republikës Çeke. Po ashtu standardet e lartpërmendura do t'i ndihmonin publikut dhe medias që të kenë më shumë informata në lidhje me strukturat e brendshme të subjektit politik, donatorët, ofruesit e shërbimeve për subjektin politik, buxhetin si dhe shpenzimet nga vet subjekti gjatë fushatës.

Një çështje tjetër shumë e rëndësishme që duhet të përfshihet në reformën zgjedhore është edhe deklarimi financiar për secilin kandidat. Me reforma duhet të përcaktohet saktë norma ligjore që do të detyronte secilin kandidat të subjektit politik, pavarësisht për pozitën që garon, të paraqes raport financiar për hyrjet dhe shpenzimet personale gjatë fushatës zgjedhore. Ky do të ishte edhe një standard tjetër i transparencës për subjektet politike, të cilat më pas do të detyroheshin që raportet e të hyrave dhe shpenzimeve t'i llogarisin në fund të raportit të tyre. Rrjedhimisht subjekti politik së bashku me kandidatët nuk do të kishte të drejtë ta kalonte maksimumin e shpenzimeve, të përcaktuara nga KQZ-ja.

Nga informatat dhe hulumtimet e mediave do të siguroheshin nga donacionet që ka subjekti politik. Pastaj do të mund të gjendeshin lidhjet në mes politikës dhe biznesit, sidomos tek pjesa e dhënies së tenderëve publik për financuesit e fushatave. Prokuroria, po ashtu do ta kishte më të lehtë në rast të hetimeve gjetjen e rasteve të korrupsionit në politikë dhe më pas sjelljen e tyre para drejtësisë.

Fusha e financimit të subjekteve politike ka nevojë edhe për studime të tjera që shtjellojnë më gjerësisht transparencën në mënyrën e financimit të subjekteve politike si dhe shpenzimeve. Rekomandimet tona mbi standardet e transparencës janë hapa pozitiv, të cilët ligjvënësit mund t'i përfshijnë në procesin e reformës zgjedhore, në mënyrë që më pas përmes ligjit këto standarde të jenë detyrime për të gjitha subjektet politike dhe kandidatët në zgjedhje.

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

ISBN

KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike. Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni www.kdi-kosova.org

Me përkrahjen financiare të:

TRANSITION

 **TRANSPARENCY
INTERNATIONAL** | Česká
republika